



Qendra për Arsim e Kosovës  
Kosova Education Center

Kodi: 039

**KEC**

## **Monitorimi i mësimdhënësve me qëllim të ngritjes së cilësisë në Edukimin e Fëmijërisë së Hershme**

### Qëllimet e Programit

Me përvetësimin e këtij programi pjesëmarrësit përfitojnë:

- Njohjen me *standardet për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme*.
- Aftësi për *vlerësimin e mësimdhënësve* sipas “Instrumentit të monitorimit”, me qëllim të ngritjes së cilësisë së punës
- Njohjen e *praktikës së përshtatshme të monitorimit të mësimdhënësve* e cila realizohet në klasë gjatë procesit mësimor.

### Përmbajtja e trajnimit

I tërë trajnimi është i fokusuar në sqarimin e “Instrumentit të vlerësimit i cili është i përbërë nga 6 Standarde për zhvillimin e edukimit në fëmijërinë e hershme:

1. Mjedisi mësimor,
2. Individualizimi dhe ndërveprimi.
3. Planifikimi dhe vlerësimi.
4. Strategjitë e mësimdhënies,
5. Familja dhe komuniteti,
6. Gjithëpërfshirja , diversiteti dhe vlera e demokracisë.

### Grupi i synuar

Ky program u dedikohet drejtorëve të shkollave fillore dhe institucioneve parashkollore, zyrtarëve të arsimit, pedagogëve, si dhe trajnerëve të programit.

### Forma e organizimit/Kohëzgjatja

Trajnimi për monitorimin e mësimdhënësve me qëllim të ngritjes së cilësisë realizohet në dy pjesë, pjesa teorike dhe praktike.

Pjesa teorike realizohet brenda tri ditëve, gjithsej 24 orë pune, ndërsa pjesa praktike realizohet dy ditë në praktikë në shkollë gjatë orës së mësimit, gjithsej 16 orë pune. Ditën e parë të praktikës pjesëmarrësit organizohen në çifte dhe monitorojnë së bashku, ndërsa ditën e dytë të praktikës nga 6 veta monitorojnë së bashku.

### Certifikimi

Kusht për certifikim është pjesëmarrja 90% në trajnim dhe gjatë monitorimit në praktikë